



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 tetor 2013
Nr.ref.:RK481/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI53/13

Parashtrues

N.T.SH. "Alba-Oil"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. Nr. 160/2011, të 13 nëntorit 2012, dhe të njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 139/12, të 25 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është N.T.SH. "Alba-Oil", kompani private nga Hani i Elezit, e përfaqësuar nga pronari i saj, Shemsedin Ramuka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. Nr. 160/2011, të 13 nëntorit 2012, dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 139/12, të 25 janarit 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar dhe njoftimi i Prokurorit të Shtetit ishin nxjerrë duke shkelur nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 prill 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 16 prill 2013, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 13 maj 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa ishte regjistruar në Gjykatë. Përveç kësaj, më 17 maj 2013, nga parashtruesi i kërkesës ishte kërkuar ta dorëzonte në Gjykatë njoftimin e kontestuar të Prokurorit të Shtetit.
8. Më 13 maj 2013, Gjykata e njoftoi Zyrën e Prokurorit të Shtetit në lidhje me kërkesën.
9. Më 22 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë njoftimin e kontestuar të Prokurorit të Shtetit.
10. Më 12 shtator 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

11. Më 4 korrik 2011, kompania AXP paraqiti padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, duke kërkuar, ndër të tjera, që parashtruesi i kërkesës si palë e paditur në procedurë civile të obligohet që të paguajë borxhin në shumë prej 25,890 eurosh.

12. Në vijim, më 24 gusht 2011, u caktua një seancë përgatitore në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, në të cilën nuk kishte marrë pjesë parashtruesi i kërkesës.
13. Në datën e njëjtë, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin për shkak të mungesës II. C. nr. 200/2011, dhe e aprovoi padinë e AXP-së. Në arsyetimin e Aktgjykimit për shkak të mungesës theksohej si në vijim: *“Pasi që pala e paditur është ftuar në mënyrë të rregullt në seancën përgatitore në këtë çështje juridike, ai nuk iu përgjigj ftesës dhe nuk e arsyetoi mungesën, të cilit edhe pse në kuptim të nenit 394 të LPK-së i është dhënë aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi, nuk e shfrytëzoi të drejtën ligjore sipas nenit 395 të LPK-së për dhënien e përgjigjes në padi, nuk e kontestoi padinë me asnjë parashtrësë ... dhe nuk ekzistojnë rrethana notore, nga të cilat del përfundimi se të paditurin e kanë penguar shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë, kushtet nga neni 151.1 i LPK-së për lëshimin e aktgjykimin për shkak të mungesës ishin plotësuar...”*.
14. Më 21 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër aktgjykimit për shkak të mungesës në Gjykatën Supreme. Në këtë ankesë, parashtruesi i kërkesës deklaroi se ka fakte të reja në këtë rast, të cilat do të mund të paraqiteshin në seancën e radhës. Sipas parashtruesit të kërkesës, ftesa për seancë i ishte dorëzuar një punëtori sezonal, i cili nuk e kishte informuar parashtruesin e kërkesës për pranimin e ftesës.
15. Më 13 nëntor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Ac. Nr. 160/2011, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe duke e vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut. Në arsyetimin e Gjykatës Supreme theksohej se *“Në ankesë, i padituri nuk e mohon faktin se një nga punëtorët e tij sezonalë e kishte pranuar ftesën e gjykatës, por siç thotë ai, punëtori nuk ia kishte dhënë atij ftesën dhe nuk ishte paraqitur në gjykatë, sepse ai nuk e kishte ditur për të. Në lidhje me një arsyetim të tillë të të paditurit, Gjykata Supreme e Kosovës konsideronte se nuk ka rrethana botërisht të njohura nga të cilat mund të përfundohet se i padituri kishte një arsye të mirë për mospjesëmarrje në seancë”*.
16. Më 28 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës i paraqiti Kryeprokurorit të Shtetit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
17. Më 25 janar 2013, Prokurori i Shtetit lëshoi njoftimin KMLC nr. 139/12, duke e njoftuar parashtruesin e kërkesës se *“pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar si dhe shkresave të tjera të lëndës, të dorëzuara nga Gjykata, konfirmon se nuk ka bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”*.

Ligji i aplikueshëm

18. Neni 394 i Ligjit për procedurën kontestimore, Nr. 03-L-006, i vitit 2009, parashikon obligimin e palës së paditur në procedurë kontestimore që të paraqesë në gjykatë përgjigjen në padi së bashku me të gjitha dokumentet relevante brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga pranimi i padisë.

19. Neni 151.1 i Ligjit për procedurën kontestimore, Nr. 03-L-006, i vitit 2009, parashikon rastet kur mund të nxirret aktgjykim në mungesë. Kjo posaçërisht ka të bëjë me situatën kur padia është dërguar së bashku me ftesën për seancën përgatitore, por pala e paditur nuk është paraqitur në seancë, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Në substancë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se janë disa parime procedurale të cilat janë shkelur, siç janë “parimi i dëgjimit publik”, “parimi i së vërtetës materiale” dhe “parimi i shfrytëzimit në mirëbesim i të drejtave procedurale”. Parashtruesi konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, me të cilën vërtetohej Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 31 dhe nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (2) b) të Rregullores që parasheh:

“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(b) ...faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

23. Parashtruesi ankohet se nuk ka pasur një gjykim të drejtë, në pajtueshmëri me garancitë e nenit 6 par. 1 të Konventës, i cili parasheh, në veçanti:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile... çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht... nga një... gjykatë...”.

24. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të përcaktuara me Ligjin për procedurën kontestimore, duke ushtruar ankesë kundër aktgjykimit në mungesë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë dhe se Gjykata Supreme në Prishtinë e ka marrë parasysh dhe iu është përgjigjur ankesave të tij mbi pikat e ligjit.

25. Gjykata përsërit se neni 6 paragrafi 1 i Konventës mishëron "të drejtën në gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, që është e drejta për të filluar procedurën në gjykata në çështjet civile, përbën një aspekt. Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk është një e drejtë absolute: ajo mund t'iu nënshtrohet kufizimeve, por këto nuk duhet të kufizojnë apo të zvogëlojnë qasjen e individit në mënyrë të tillë ose në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i së drejtës (Shih de Geouffre de la Pradelle kundër Francës, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, Seria A nr. 253-B, p. 41, paragrafi 28).
26. Një nga elementet e një gjykimi të drejtë sipas nenit 6 paragrafi 1, është e drejta e procedurës akuzatore; secila palë duhet në parim të ketë mundësi jo vetëm për të bërë të njohur ndonjë dëshmi të nevojshme që pretendimet e tij të kenë sukses, por edhe të ketë njohuri dhe t'i komentojë të gjitha provat e nxjerra apo vërejtjet e paraqitura me qëllim të ndikimit në vendimin e gjykatës (Shih, ndër të tjera, rasti Mantovanelli kundër Francës, aktgjykimi i GJEDNJ-së 18 marsit 1997, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-II, f. 436, para. 33).
27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësinë që të parashtrojë prova që janë në favor të tij dhe kundër aktgjykimit në mungesë, të nxjerrë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, por nuk e ka shfrytëzuar atë mundësi.
28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, pas shqyrtimit të hollësishëm të fakteve të rastit, Gjykata Supreme gjeti në një vendim të arsyetuar se parashtruesi e kishte marrë ftesën për procedurën përkatëse, kështu që mosparaqitja e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë i ishte atribuar mungesës së kujdesit nga ana e tij. Me fjalë të tjera, sikur parashtruesi i kërkesës të kishte vepruar me kujdes, ai do të kishte qenë në gjendje që të merrte pjesë në seancën publike (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i Canete de Goni kundër Spanjës, Kërkesa nr. 55782/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 15 janarit 2003).
29. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljet e ndonjë të drejte të tij, të garantuar me Kushtetutë dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* për një shkelje të tillë (Shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
30. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa nuk është parashtruar në Gjykatë në mënyrë ligjore, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores, dhe si e tillë është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 36 (2) (d) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani